LAVDI QËNDRESTARËVE TË ÇDO KOHE!

Libri: “MUSINE KOKALARI – NJË YLLËSI”

Shkruar nga Uran Butka



Kushtuar kësaj figure të shquar të

disidentes antikomuniste shqiptare, që i tha botës me guxim:

“NUK KAM NEVOJË TË JEM KOMUNISTE QË TA DUA VENDIN TIM.”

Kjo është një thirrje ndërgjegjeje ndaj të gjithë indiferentëve që nuk luftojnë kundër fenomeneve të tilla si:

Diktatura, autokracia, padrejtësia, tradhtia, hajnía, korrupsioni, patronazhimi, spiunimi, servilizmi, konformizmi, abuzimi, të cilat i zgjasin jetën regjimeve autoritare, dhe një nderim për të gjithë qëndrestarët që luftojnë kundër tyre.

Në nderim të saj, po e postoj, të përkthyer në gjuhën shqipe, këtë si një homazh, në një video të inskenuar nga profesoresha e Universitetit Leeds në Mbretërinë e Bashkuar, Dr. Agata Fijalkowski, interpretuar nga aktorja Alice Lloyd-Davis (atë që nuk di ta kenë bërë ende artistët shqiptarë). nderuar! Krimi për të cilin jemi akuzuar unë dhe të pandehurit e tjerë, nuk është asgjë tjetër veçse fakti që i kemi dërguar një mesazh aleatëve perëndimorë, ku ju kemi shprehur dëshirën tonë

që zgjedhjet në Shqipëri të shtyhen. Kjo nuk do të thotë se ne dëshirojmë të përmbysim regjimin aktual, me force, pra Pushtetin Populllor. Ne, të 37 – të, të pandehurit, në bankën e të akuzuarve, jemi anëtarë të katër partive të ndryshme. Këto parti kanë bërë koalicion edhe pse kanë koncepte dhe ide të ndryshme shoqërore dhe politike. Ky koalicion nuk është as bashkim, as shkrirje midis nesh. I nderuar zoti gjykatës! Në vend të kësaj, ai është një angazhim moral midis palëve. Secili grup është i angazhuar në aktivitetet e tij që i përshtaten frymës së vet. Secili grup është përgjegjës për veprimtarinë e vet. E vetmja gjë që kemi të përbashkët është kërkesa për shtyrjen e zgjedhjeve. Jemi në prag të rindërtimit të vendit tonë të dalë nga lufta me dëme të mëdha, me shumë plagë materiale e morale. Jemi në prag të zbatimit të reformave sociale siç është ndryshimi i formës feudale të jetësës dhe krijimit të një shoqërie demokratike. Partitë tona i duan këto

reforma siç i do edhe Fronti Demokratik. Por ne duam të ekzistojmë veçmas nga ky front. Ne duam të jemi pjesë e një familjeje demokratike e cila ndjek një rrugë të qëndrueshme politike, drejt unitetit moral të pakicës dhe shumicës, ku ky grup i vogël partish gjen momentin e duhur për të dalë nga errësira në dritë. Ne e pamë të arsyeshme të hartonim një program të përbashkët që është në përputhje me atë të Frontit. Secila palë ka strukturën e brendshme të programit social dhe mënyrën e veprimtarisë së saj. Por ne jemi të të njetit mendim se zgjedhjet duhet të shtyhen. Kjo do t'u japë partive të tjera mundësinë për t'u organizuar, për të bërë fushatë dhe për të pasur shansin që të luftojnë për të fituar zgjedhjet shumëpartiake. Kjo është arësyeja se përse ato plane u hartuan bashkë me aleatët, në mënyrë që kjo opozitë dhe qëndrimi ynë zyrtar të respektohet dhe se nuk do të ketë manovra të pahijshme dhe se ky kundërshtim nuk

do të injorohet. Unë u ktheva në këtë gjykatë për t'u hetuar edhe një here për veprimtarinë time, prandaj: Kërkoj drejtësi! Nëse do të dënohesha për veprat e sipërpërmendura, unë do ta pranoja me kënaqësi dënimin më të ashpër ndaj meje! Nuk është e nevojshme të jem komuniste që ta dua vendin tim.

LAVDI QËNDRESTARËVE TË ÇDO KOHE!

LAVDI MUSINE KOKALARIT!